



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Nr. 444/5 Prot

Tepelenë më 08.04.2026

VENDIM

Nr. 14/11 datë 08.04.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL NË BASHKINË TEPELENË”**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64/j; në VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pikat 3 dhe 11; në VKB nr. 75, datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026”; në VKB nr. 76, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm”; si dhe Vendimin nr. 14\_, datë 02.04.2026 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026”,

**VENDOSA**

1. Të miratoj planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil në Bashkinë Tepelenë, sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Numri i përgjithshëm i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2026 është 20 (njëzet), të ndara sipas kategorive si më poshtë:
  - a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues – 1 (një);
  - b) Për kategorinë e mesme drejtuese – 3 (tre);
  - c) Për kategorinë e ulët drejtuese – 4 (katër);
  - d) Për kategorinë ekzekutive – 12 (dymbëdhjetë)
3. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm për kategoritë janë si më poshtë:
  - Shkenca juridike;
  - Shkenca ekonomike;
  - Shkenca inxhinierike;
  - Arkitekturë;
  - Gjeodezi;
  - Shkenca shoqërore.
4. Kriteret e pranimit:
  - a) Për trupën e nëpunësve civilë:
    - Për nivelin e lartë drejtues: Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil;
    - Për kategorinë e mesme drejtuese (3 nëpunës): Kandidatët duhet të jenë të pajisur me diplomë “Master i Shkencave” (niveli i dytë);

- Për kategorinë e ulët drejtuese (3 nëpunës): Kandidatët duhet të jenë të pajisur me diplomë “Master Profesional” ose “Master i Shkencave”;
  - Për kategorinë ekzekutive (12 nëpunës): Kandidatët duhet të jenë të pajisur me diplomë “Bachelor”, “Master Profesional” ose “Master i Shkencave”.
5. Ngarkohet Drejtoria Ligjore dhe e Shërbimeve Organizative për zbatimin e këtij vendimi.
  6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**

Gramos Sako





INSTITUCION : BASHKIA TEPELENË

Tabelë 1

“Për zbatimin e ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” në lidhje me planin vjetor të pranimit në shërbimin civil Bashkisë Tepelenë”

<u>Emertimi i drejtorisë së shërbimeve DPD</u>	<u>Kategoria e nëpunësit</u>	<u>Numri</u>
<u>Sekretar i përgjithshëm</u>	<u>Sekretar i përgjithshëm</u>	<u>1</u>
<u>Spektori i auditimit</u>	<u>specialist</u>	<u>1</u>
<u>Spektori i Financës</u>	<u>Specialist</u>	<u>1</u>
<u>Specailist</u>	<u>Specialist</u>	<u>1</u>
<u>Spektori I tatim-taksa</u>		
<u>Drejtoria DLSHO</u>	<u>Përgjegjes</u>	<u>2</u>
<u>Spektori ligjor dhe BNJ</u>		
<u>DPZHKT</u>	<u>Drejtor</u>	<u>1</u>
	<u>Speciliste</u>	<u>5</u>
<u>Drejtoria e Shërbimeve Publike</u>	<u>Drejtor</u>	<u>1</u>
<u>Spektori i menaxhimit të pyjeve kullotave</u>	<u>Specialist</u>	<u>2</u>
<u>Drejtoria e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit Integrimin European, Diaspores dhe Migracionit</u>	<u>Drejtor</u>	<u>1</u>
	<u>Përgjegjës</u>	<u>2</u>
	<u>Specialist</u>	<u>1</u>
<u>Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Kujdesit Social</u>	<u>Specialist</u>	<u>1</u>